



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 178 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osman i anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në afersi prej 100m përreth qendrës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 15.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 16.06.2012, rreth orës 09:00 në Kaçanik, në shtyllën në hyrje të shkollës së mesme, gjimnazi “Skënderbeu” militantë të PDK-së nuk kanë larguar posterët e kandidatit të tyre për kryetar komune Besim Ilazi. Parashtresi i ankesës pretendon se me këtë rast subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore 13/2009 neni 7.1 pika b) dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 16.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.06.2012, në ora 12:00.

PZAP, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar, në PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se militantë të subjektit politik PDK, nuk kanë larguar posterat e kandidatit të tyre për kryetar komune nga hyrja e gjimnazit

Skënderbeu. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore të parashtuara në ankesë janë të pa baza pasi që nga fotografit e ofruara nuk shihet se për çfarë objekti bëhet fjalë dhe se nga fotot e ofruara nuk mund të identifikohet në asnjë moment objekti që pretendohet se është shkollë e i cili shërben si Qendër e Votimit, prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pabazë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetkatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 178 /2012 më datën 18.06.2012.

